

Nr. 6 Regj.**Durrës, më 17. 05.2024****Lënda:** Në përgjigje të kërkesës suaj.

Emër Mbiemër

Në kuadër të implementimit të Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe në referencë të kërkesës suaj, datë 13.05.2024 me objekt “[Kërkesë për informacion mbi aktivitetin e hekurudhës.](#)”, e regjistruar në regjistrin e “Kërkesë/Ankesë/Përgjigje” në përputhje me nenin 8 të ligjit të sipërcituar me nr. 6, ju informojmë sipas pyetieve të parashtruara për si vijon:

1. Në çfarë faze janë punimet për hekurudhën Tiranë - Durrës?

Implementimi i projektit të “Rehabilitimit të linjës hekurudhore “Durrës- Tiranë” dhe ndërtimi I linjës së re hekurudhore në drejtim të Aeroportit ndërkombëtar të Rinasit (TIA), vijon me ritme të kënaqëshme, duke respektuar planin e punimeve. Nga raportimi i fundit i bërë në fillim të muajit maj 2024, rezulton të jenë kryer 68% e punimeve ndertimore.

Punohet intesivisht në trasenë hekurudhore, ku aktualisht janë ndërmarr veprime konkrete në shtrimin e shinave hekurudhore dhe ndërtimin e Urave te Reja. Ka nisur faza e dytë e projektit në tenderimin e stacioneve hekurudhore, ndërkohë kanë përfunduar tetë urat e nevojshme të këtij projekti hekurudhor. Segmenti Domje- Rinas mbetet ende në fazën e shpronësime, ndërkohë po finalizohen ndryshimet që lidhen me zgjatimin e linjës hekurudhore, nga PTT në fundin e Bulevardit “Zogu i Parë” duke përfunduar dizenjimin e projektit të detajuar inxhinierik dhe ndërmarrjen e masave për sigurimin e financimit për këtë projekt mjaft të rëndësishëm.¹

2. Kur pritet të përfundojnë punimet?

Linja hekurudhore “Durrës -Tiranë” së bashku me segmentet hekurudhore përkatëse (Domje - Rinas), përfundon brënda tremujorit të parë të vitit 2025.²

3. Cilat janë arsyet e vonesave në këtë projekt?

¹ Përgjigje e dhene ne pyetien nr. 3 te kerkese nr. 2 te publikuar ne regjistrin e kerkesave dhe pergjigjeve (2024).

² Përgjigje e dhene ne pyetien nr. 3 te kerkeses nr. 1 te publikuar ne regjistrin e kerkesave dhe pergjigjeve (2024).

Implementimi i projektit, ka regjistruar vonesa të finalizimit të tij (projektit). Në këtë pikë vlen të theksojmë ndikimin e shkaqeve objektivist të pavarura nga zbatuesit e projektit, si elektifikimi i linjës hekurdhore, një element ky i rëndësishëm i paprojektuar më parë, apo ndërtimi i godinave të stacioneve hekurdhore dhe urave hekurdhore, të projektuar më parë gjithashtu vetëm për rikonstrukcion. Nisur nga ndodhite natyrore dhe elementeve të tjera që lidhet kryesisht me amortizimin, u vlerësua që të rishihet projekti dhe të vlerësohet rindërtimi i urave dhe stacioneve hekurdhore dhe ndërtimi i segmentit hekurdhor në drejtim të Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit (TIA). Shkak për shtyerjen e afatit të përfundimit të punimve është dhe zgjatimi i linjës hekurdhore prej 4 km nga PTT në drejtim të Bulevardit “Zogu i Parë”. Dosja e shpronësimeve është gjithashtu një ndikues i rëndësishëm në vonesat e shkaktuara. Proçes ky tërësisht i pavarur nga Shoqëria apo kontraktori. Megjithatë në mbledhjen e fundit të qeverisë u miratua shpronësimi i pasurive të cilat preken nga ndërtimi i linjës së re hekurdhore nga Domje në drejtim të Rinas.³

**Autoriteti publik “Hekurudha Shqiptare” Sh.A, angazhohet në garantimin e të drejtës së informimit, si garanci kushetuese dhe vepron në mbështetje të ligjit Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të Drejtën e informimit” dhe trajton kërkesën tuaj në përputhje me Ligjin nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.*

Me konsideratë!

KOORDINATORI I TË DREJTËS SË INFORMIMIT

Domeniko SINJARI

³ Pergjigje e dhene ne pyetien nr. 2 te kerkeses nr. 2 te publikuar ne regjistrin e kerkesave dhe pergjigjeve (2024).